# DËSHMI ARKIVI

**A-446395**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Protesta të fermerëve në Holandë kundër buxhetit: zjarre pranë autostradave dhe sabotim i shinave hekurudhore |
| ADRESA | `https://albeu.com/lajme/bota/protesta-te-fermereve-ne-holande-kunder-buxhetit-zjarre-prane-autostradave-dhe-sabotim-i-shinave-hekurudhore/1012844/` |
| BURIMI | albeu.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 15 shtator 2026, 14:40:27 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 15 shtator 2026, 14:37:44 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `e761f0e15fa95c9b658c6bffc3c0e128e4bb5d648bf21d69b1e54acd6a30a8d8` |
| TEKSTI | `401e08b654fa8e221707db315461c8b94e9295601e957f5dab58ebcb8c333f15` |
| PAMJA | `727f3fccf0d981d407d56eea2683c450bcd19153f5f83fc9d8a9559c8baf554d` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `8cd942e9db779879d8c21be60cad9c3a72e5479102cc685f63f2ac8ba208cd0d` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `20a2ff67bec0970ebd6ac7b02e4b09aabe3ec6a4bb974bdfd1be2c012f68e490` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/8cd942e9db779879d8c21be60cad9c3a72e5479102cc685f63f2ac8ba208cd0d`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Protesta të fermerëve në Holandë kundër buxhetit: zjarre pranë autostradave dhe sabotim i shinave hekurudhore




Holanda u përballë me kaos në trafik pasi fermerët ndezën zjarre pranë autostradave, ndërsa autoritetet nisën hetimet për një akt sabotimi në rrjetin hekurudhor, në prag të çeljes zyrtare të sesionit të ri parlamentar.

ProRail, kompania përgjegjëse për administrimin e infrastrukturës hekurudhore në vend, njoftoi se tuba të hollë ishin fiksuar me qëllim në shina në mbi 20 lokacione. Shumica e rasteve u evidentuan në zona rurale të pjesëve qendrore dhe lindore të Holandës.

Vendosja e tubave solli pezullimin e qarkullimit të trenave në linjat e prekura dhe shkaktoi vonesa e ndërprerje të ndjeshme edhe në segmente të tjera të rrjetit, mes tyre edhe në linjat ndërkombëtare që lidhin Holandën me Gjermaninë.

Sipas ProRail, materialet nuk ishin vendosur aksidentalisht, ndaj ngjarja është trajtuar si sabotim. Përveç pengimit të trenave, tubat ndikuan edhe në qarkullimin rrugor, pasi disa kalime në nivel u mbyllën.

Për zbardhjen e rastit është angazhuar edhe AIVD, agjencia holandeze e inteligjencës, e cila po punon së bashku me policinë dhe prokurorët. Deri tani, AIVD nuk ka bërë publike të dhëna për hetimin.

Ndërkohë, rreth mesditës, në disa pika përgjatë autostradave u regjistruan zjarre. Si pasojë, autoritetet mbyllën pjesë të rrugëve, ndërsa trafiku pësoi vështirësi të mëdha.

Forca e Mbrojtjes së Fermerëve deklaroi se pas zjarreve qëndronin fermerë të revoltuar, të cilët zgjodhën ditën e prezantimit të buxhetit qeveritar për të djegur balla me sanë dhe goma automjetesh.

“Ndjejmë sikur vendi është në flakë. Fermerët ndiejnë sikur bizneset e tyre po digjen nga planet e qeverisë”, u

të fundit/

Rrustemi: Kandidatura e Sejdiut ishte një mundësi e humbur, p…

DHTIK dhe Komuna e Vitisë lidhin marrëveshje për…

Prokurorja Laura Pula përfundon karrierën dhe del në pension

Gruda: Shpresojmë që nesër katër ish-drejtuesit e UÇK-së t…

Investim në arsim i ABI Bank, gjithëpërfshirje dhe mundësi të…

Barcelona synon të transferojë te Manchester Unitedi…

Rodri rrëfen cilin futbollist do të afronte te Barcelona

Aleanca për Media Etike ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

shpreh zëdhënësja e organizatës, Sita van Keberma.

Organizata hodhi poshtë çdo përgjegjësi për dëmtimin e linjave hekurudhore, por nuk përjashtoi mundësinë që veprime të tilla të jenë kryer individualisht nga fermerë të zemëruar.

Protestat kanë në qendër planet e qeverisë për buxhetin e vitit 2027, të cilat fermerët i kundërshtojnë prej muajsh. Ata thonë se po mbajnë padrejtësisht përgjegjësi për ndotjen nga nitratet dhe kundërshtojnë projektet për restaurimin e habitateve, pasi këto masa mund të ndikojnë në aktivitetin e tyre.

Projektbuxheti u bë publik nga Mbreti Willem-Alexander në nisje të mandatit të ri parlamentar. Në fjalimin e hartuar nga Kryeministri Rob Yeats, mbreti tha se do të ishte "e papërgjegjshme" të mos trajtohej ndotja nga azoti, edhe në rast se masat do të sillnin pasoja për fermerët.

Qeveria ka deklaruar se do të ofrojë kompensim financiar për fermerët dhe bizneset që preken nga planet për restaurimin e habitateve.

Shtuar më 15.09.2026 16:37


Lehtësimi fiskal për karburantet/ Maqedonia e Veriut, Italia, Spanja dhe…


Trump kundërshton rregullat shtesë për AI-n: Mos kini frikë nga…


Bill Gates: Qeveritë në mbarë botën janë shumë prapa në zhvillimet e…


Arrestohen në Athinë dy grekë që dyshohet se tentuan të vidhnin një motor


Trump publikon heliportin e ri në Shtëpinë e Bardhë: Synoj t'i rikthej rezidencë…


OKB-ja thërret mbledhje urgjente për kontrollin e Ngushticës Bab el-Mand…


Lirohet Ilias Kasidhiaris, ish-"numri 2" i Agimit të Artë synon rikthimin në politik…


Ish-zëvendësi i Agimit të Artë lirohet nga burgu, paralajmëron rikthimin…

albeu që nga viti 2003 © 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...  Kërko

**Kryesore**
Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

**Kategori**
Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

**Linqet**
Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

**Tags**
Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

**Moti**
Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kontaktoni | Kushtet e Përdorimit | Privacy Policy | Powered by: orihost.com

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.